



**CARITAS
KOSOVA**

Raporti Vjetor

2018

Përmbajtja

2	Kush jemi ne
3	Të dashur miq të Caritas Kosova
4	Përkujdesi Shtëpiak dhe Ambulantor
6	Lufta Kundër Trakifimit me Njerëz
7	Paqa dhe Diversiteti
10	Mbështetja e Personave me Aftësi të Kufizuara
13	Përfshirja Sociale e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian
17	Ushqim për të gjithë
17	Përtej Portave të Burgut
20	Edukimi i Fëmijëve
21	Ekonomia Sociale
22	Your Job
23	Njohuria kundër dhunës dhe trafikimit
25	Emergjencat
26	Buxheti Vjetor

Kush jemi ne!

Cartias Kosova është institucion i Kishës Katolike në Kosovë misioni i së cilës është promovimi i paqes, solidaritetit, dhe dashurisë në mes të njerëzve. Caritas Kosova është anëtare e Caritas Internationalis (CI) dhe Caritas Europa (CE) që shërben dhe ofron ndihmë për më të varfërit pa dallim race, kombësie, religjioni, etj. Aktiviteti i Caritas Kosova në vitin 2018, në përputhje me strategjinë, ishte zbatimi i programeve dhe projekteve në kuadër të 4 mandateve operationale: Asistenca Sociale dhe Shëndetësore, Zhvillimi i Qëndrueshëm, Avokimi dhe Lobimi, dhe Asistenca në Emergjencë dhe Rehabilitimi i Qëndrueshëm (në gatishmëri). Nëpërmjet veprimeve të shumta, jemi përpjekur të jemi në afërsi të atyre që janë në nevojë për të lehtësuar problemet në të cilat ata jetojnë, siç janë varfëria dhe izolimi.

Udhëheqja jonë

President i Caritas Kosova është Mons. Dodë Gjergji - Ipeshkëv i Kosovës dhe Drejtor Gjeneral është Don Viktor Sopi.

“Me mbështetjen dhe angazhimin e miqve, punonjësve dhe vullnetarëve të Caritasit, ne po vazhdojmë të luajmë rolin tonë të veçantë në shoqëri si dora sociale e Kishës Katolike e cila kujdeset për të varfërit, të sëmurët, të disavantazhuarit, të përjashtuarit dhe të gjithë ata që kërkojnë drejtësi sociale e ngrohtësi të zemrës”. - Don Viktor Sopi.

Të nderuar partnerë dhe miq të Caritas Kosova, në këtë raport vjetor gjeni informacion mbi aktivitetet e zbatuara në mbështetje të personave në nevojë gjatë vitit 2018.

Të dashur miq të Caritasit



Me mbështetjen dhe angazhimin e miqve, punonjësve dhe vullnetarëve të Caritasit, ne po vazhdojmë të luajm rolin tonë të veçantë në shoqëri si dora sociale e Kishës Katolike e cila kujdeset për të varfrit, të sëmurët, të disavantazhuarit, të përjashtuarit dhe të gjithë ata që kërkojnë drejtësi sociale e ngrohtësi të zemrës.

Viti 2018 ka qenë shumë i suksesshëm në zbatimin e masave të ndryshme të cilat Caritas Kosova i ndërmerr për të përmbushur Misionin e saj që është mbrojtja dhe promovimi i dinjitetit njerëzor si epiqendra e çdo veprimi bamirës që ne ndërmarrim.

Edhe këtë vit kemi vazhduar që të jemi pranë personave të sëmurë e të vetmuar, që të ju lehtësojmë dhimbjen e të ju kthejm buzëqeshjen. Kemi qenë pranë personave me aftësi të kufizuara që sadopak të ju largojmë barrierat dhe t'i përfshijmë aktivisht në jetën shoqërore. Jemi angazhuar shumë që të krijojmë atmosferë të mirë në mes të komuniteteve të ndryshme që jetojnë në Kosovë dhe kemi promovuar diversitetin etnik e fetar si vlerë e shtuar e shoqërisë kosovare. Qëndruam pranë viktimave të dhunës e trafikimit duke i përkrahur në ri-fillimin e një jete të re pa dhunë dhe pa dhimbje. Me shumë përkushtim jemi

angazhuar edhe për ata që kanë lirinë e kufizuar dhe i kemi motivuar që të rigjejnë vetëveten dhe motivin për të arritur përparimin. Kemi qëndruar pranë më të varfërve që sado pak të lehtësojmë vështirësitë e tyre për ekzistencë. Jemi angazhuar fuqishëm që fëmijët të kenë edukim dhe përkujdesje adekuate ndërsa për të rinjt tanë jemi kujdesur që të jenë jo vetëm e ardhmja por edhe e tashmja e shoqërisë sonë.

Pa pushim kemi avokuar e lobuar që zëri i të nëpërkëmurve të jetë prezent në proceset vendimmarrëse, në mënyrë që politikat zhvillimore dhe strategjitë e ndryshme të burojnë nga nevojat që ata kanë dhe të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes së tyre.

Gjatë këtij viti Caritasi i ka kushtuar vëmendje të posaqme edhe zhvillimit organizativ dhe avansimit profesional, duke përcjellë trendet globale dhe duke rritur gatishmërinë për të shërbyer edhe më mirë, edhe më shumë.

Të dashur miq të Caritas Kosova, ju falenderoj për përkushtimin e treguar gjatë vitit 2018 dhe ju thërras vëllazërisht që të vazhdoni angazhimin tuaj në bamirësi, si një nga vlerat më sublime që kuptimëson ekzistencën njerëzore dhe që fisnikëron shpirtin dhe mendjen.

Zoti ju bekoftë!

Don Viktor Sopi – Drejtor Gjeneral

Përkujdesi Shtëpiak dhe Ambulantor

Përkujdesi Shtëpiak/Home Care - Duke përdorur modelin e Përkujdesit Shtëpiak Gjerman dhe me mbështetjen e Caritasit Gjerman, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunave, Caritas Kosova ka zbatuar programin e Përkujdesit Social dhe Shëndetësor në shtëpi. Ky program është zbatuar në 13 komunitet ku përfitues kanë qenë personat më të cenueshëm dhe të vetmuar, të moshuar dhe të braktisur, personat me aftësi të kufizuara dhe të sëmurët

mendorë, pavarësisht nga besimi, etnia dhe gjinia e tyre. 2250 përfitues kanë përfituar përmes këtij programi duke pranuar shërbime bazike shëndetësore dhe sociale.

Caritas Kosova në vitin 2018 është licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për persona të moshuar, persona me aftësi të kufizuara dhe fëmijë të marginalizuar në nivel nacional.



Përkujdesi Ambulator - Në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunat: Viti, Drenas, Rahovec, Prizren, Istog, Suharekë, Mamushë, Fushë Kosovë, Shtime, Skënderaj, Gjilan, Mitrovicë dhe Obiliq, në vitin 2018 Caritas Kosova ka zhvilluar aktivitete në kuadër të projektit të Përkujdesit Ambulator.

Përmes këtij projekti Caritas Kosova në bashkëpunim me partnerët institucional ka arritur të ofroj mbi 1 milion shërbime sociale dhe shëndetësore.

Këto shërbime janë ofruar nga 550 punonjës shëndetësor dhe punëtor social. Të dy komponentët e shërbimeve e plotësojnë njëra tjetrën duke ofruar një shërbim unik në Republikën e Kosovës.



Partnerët: Caritas Germany, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Komunat: Viti, Drenas, Rahovec, Prizren, Istog, Suharekë, Mamushë, Fushë Kosovë, Shtime, Skënderaj, Gjilan, Mitrovicë, Obiliq

Lufta kundër Trafikimit me Njerëz

Lufta kundër Trafikimit me Njerëz, vazhdon të jetë një prej prioritetëve të veprimtarisë së Caritas Kosova. Ky fenomen është plagë serioze që ka ndikuar në njerëzimin në të gjitha kohërat dhe Caritas Kosova është e përkushtuar në parandalimin e kësaj dukurie me fokus të veçantë tek fëmijët dhe gratë. Brenda programit të cilin e zbaton Caritas Kosova janë tri komponente: Parandalimi, Ngritja e vetëdijesimit të qytetarëve dhe Mbrojtja dhe Ri-integrimi i Viktimave (potenciale) të trafikimit. Në vijim janë të arriturat për vitin 2018:

Parandalimi - CK ka kontribuar në parandalimin e trafikimit përmes trajnimit të mësimdhënësve dhe këshillin e prindërve për identifikimin e hershëm të faktorëve të rrezikut si dhe referimin e rasteve.

Këto trajnime janë mbajtur në katër komuna: Gjilan, Klinë, Kamenicë, dhe Hani i Elezit ku gjithsej janë trajnuar 70 mësimdhënës dhe staf shkollor i shkollave fillore.



Ngritja e vetëdijesimit të qytetarëve – Caritas Kosova ka prodhuar filmin dokumentar të titulluar "RRUGA" ku luan aktorë të mirënjohur kosovar dhe ky film trajton temën e trafikimit të njerëzve.

Premiera e Filmit është shfaqur në Kino ABC në dhjetor të vitit 2018 dhe pjesëmarrës ishin përfaqësues të ndryshëm të institucioneve relevante dhe pjesëtar të shoqërisë. Filmi është shfaqur edhe në TV nacionale për të ngritur vetëdijen në lidhje me rëndësinë e luftimit të trafikimit të qenieve njerëzore.

Partnerët: Secours Catholique – Caritas France, Catholic Relief Services, Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Ferizajt

Mbrojtja dhe Ri-integrimi i Viktimave (potenciale) të trafikimit – Në bashkëpunim me Strehimoret në Gjilan dhe Pejë dhe me Qendrat për punë Sociale, kemi ofruar mbështetje dhe kemi kontribuar në procesin e ri-integrimit për 8 Viktima (potenciale) të trafikimit duke iu ofruar trajnime profesionale.

Caritas Kosova po ashtu ka avokuar në platforma regjionale (Euro-Mesdhetar) dhe globale (COATNET) si përfaqësues i shoqërisë civile nga Republika e Kosovës.

Paqa dhe Diversiteti

Megjithë situatën e pafavorshme socio-ekonomike të shkaktuar nga ndikimi i politikës, veçanërisht në rajonin e Mitrovicës, Caritas Kosova ka vazhduar më tej promovimin e vlerave të paqes dhe pajtimit përgjatë zbatimit të aktiviteteve gjithëpërfshirëse në kuadër të Programit të Paqes dhe Diversitetit, me qëllimin përfundimtar të ofrimit të mundësive të njëjta për njerëzit e marginalizuar ose me nevoja specifike, sikur anëtarët e tjerë të shoqërisë.

Ndër përfituesit e "Bujqësia dhe gjener-

imi i të ardhurave" nën komponentën e Zhvillimit Ekonomik, për të qenë sa më gjithëpërfshirës, janë përfaqësuar më shumë se tre bashkësi që banojnë në Mitrovicë. 61 përfitues ishin pjesë e vizitave studimore dhe aktivitetit të shkëmbimit, në mesin e të cilave 4 përfitues (2 gra dhe 2 të rinj) janë mbështetur përmes grantit për zhvillimin e biznesit të tyre.

"Unë falënderoj përzemërsisht Caritas-in e Kosovës për mbështetjen e vazhdueshme që kur isha fëmijë", tha Sadete Gashjani, përfituese.

Për sa i përket "Punësimi" i cili është gjithashtu pjesë e komponentës së Zhvillimit Ekonomik, 10 të rinj me përkatësi të ndryshme etnike ishin pjesë e aktiviteteve. Midis tyre, 4 më të rregullt ishin pjesë e procesit të mëtutjeshëm të ngritjes së kapaciteteve individuale ndërsa 1 përfitues ndoqi praktikën në njërën prej kompanive. Arlind Ibishi, përfituesi i punës praktike tha: *"Falë Caritasit, unë e di se si të shprehem në një mjedis pune. Unë shoh që teoria dhe praktika e mirë të dërgon drejt suksesit".*

Përfituesit e "Përfshirjes së fëmijëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian" nën komponentën e ndihmës sociale dhe arsimore, ishin 40 fëmijë me përkatësi të ndryshme etnike dhe fëmijë me aftësi të kufizuara të cilët morën pjesë në punëtori në terren, ndërsa 30 fëmijë dhe të rinj, përfshirë fëmijë me aftësi të kufizuara, morën pjesë në ngjarjen e "Ditës Botërore të Fëmijëve" e organizuar në partneritet me UNICEF.



Sa i përket "Vullnetarëve", 20 prej tyre janë regjistruar në platformën nacionale të vullnetarëve, 14 prej tyre, përfshirë 2 me aftësi të kufizuara, janë trajnuar në "Konceptin Themelor të përgatitjes së projekt propozimeve" dhe "Qasja te fëmijët me nevoja të veçanta". Duke marrur pjesë në trajnim ata kanë ngritur aftësitë që të transmetojnë njohuritë e tyre tek bashkëmoshatarët. Organizimi i vizitës studimore dhe shkëmbimit të përvojave me rrjetin e vullnetarëve nga Peja dhe Prizreni ka ngritur njohuritë e

vullnetarëve të Mitrovicës dhe ka ndikuar në krijimin e relacioneve reciproke.

Në ngjarjet si Dita Ndërkombëtare e Paqes dhe Dita Botërore e Fëmijëve, afro 200 fëmijë morën pjesë në seminarin për ngritjen e vetëdijes, ndërsa 80 familje të varfëra në nevojë, Qendrat e Burimore në Veri dhe Jug dhe Qendrat Kolektive, u mbështetën me pako humanitare për Ditën Ndërkombëtare të Bamirësisë.



Mbështetja e Personave me Aftësi të Kufizuara

Ecim së bashku drejt gjithëpërfshirjes - Qendra e Edukimit të Hershëm - Qëllimi i përgjithshëm i projektit është mbështetja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në rajonin e Prizrenit për të realizuar të drejtën e tyre për arsim. Qendra e kujdesit dhe edukimit të hershëm numëron 45 fëmijë me aftësi të kufizuara të ndryshme si dhe prindërit e tyre si përfitues direkt. Përveç aktiviteteve të përditshme në mësim, sociale dhe fizike të ofruara në qendër, një veprim i rëndësishëm është regjistrimi i fëmijëve në sistemin e rregullt shkollor si pjesë e strategjisë së re të përfshirjes. Gjatë vitit 2018, 14 raste të reja u regjistruan në qendërën tonë për të marrë shërbimet tona ditore. Rezultati i angazhimit tonë në vitin 2018 është se ne kemi arritur të regjistrojmë tetë fëmijë

me aftësi të kufizuara në programin e rregullt parashkollor dhe shkollor dhe gjithashtu kemi ofruar 5 Asistentë të Mësimdhënësve në shkollat e rregullta të rregulluara me Memorandum Mirëkuptimi me Drejtorinë Komunale të Arsimit në Prizren.

Prindërit e fëmijëve janë po ashtu grup i synuar të cilët ishin akter aktiv dhe i rëndësishëm në arritjen e rezultateve të këtij projekti. Interesimi i tyre për aktivitetet e planifikuara dhe pjesëmarrja e tyre aktive në grupet e prindërve të vetë-ndihmës ishin edhe tregues për suksesin e kësaj iniciative të veçantë. Përveç kësaj, kontributi i tyre fokusohet kryesisht në ofrimin e ideve për përmirësimin e shërbimeve, gjë që mbetet një qëllim i rëndësishëm në vazhdim.



SOCIETIES/Mbështetja e OSHC-ve në Fuqizimin e Aftësive Teknike, Përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Standardet e BE-së në Evropën Juglindore - Objektivi i përgjithshëm i SOCIETIES është përmirësimi i kapaciteteve të OSHC-ve në menaxhimin e proceseve të përfshirjes sociale dhe në promovimin e politikave të përfshirjes sociale, përmes një dialogu efikas me autoritetet publike gjatë proceseve të vendimmarrjes. Caritas Kosova është anëtare në mesin e 15 organizatave të tjera nga Evropa Lindore dhe Italia që bashkërisht po zbaton projektin SOCIETIES. Në vitin 2018 projekti ka trajtuar çështje të ndryshme përmes planit të veprimit të vet dhe fokusimin e programit për ngritjen e kapaciteteve për OSHC-të, vizitë studimore në vendet e BE-së, përfshirjen sociale, fushatat ndërgjegjësuese, etj.

Në muajin Maj 2019 u organizua vizita studimore në Milano/Itali. Gjatë kësaj vizite pjesëmarrësit patën mundësinë të shohin funksionimin e sistemit të mbro-

jtjes sociale bazuar në shërbimet e komunitetit dhe ndërmarrjet sociale. Përveç pesë organizatave të Caritas-eve nacionale të përfshira në projekt, duke përfshirë Caritas Kosova, pjesëmarrës ishin edhe 15 antarë të shoqatave të personave me aftësi të kufizuara dhe çrregullimeve mendore nga vendet e rajonit, të cilat janë fituesit e skemës së granteve në kuadër të këtij projekti. Vizita pesë-ditore ishte organizuar nga Psikologi per il Popoli nel Mondo nga Milano, e cila në projekt ka rolin e partnerit. Programi përfshinte vizita në kooperativa të ndryshme që ofrojnë shërbime për njerëzit me aftësi të kufizuara, aftësi të kufizuara mendore ose intelektuale. Veçanërisht interesante ishin përvojat e Cooperative Lotta contro l'Emarginazione, Olinda and Cooperativa Archipelago. Të tre kooperativat ofronin shërbime sociale inovative për grupet e synuara: nga shërbimet që synojnë fitimin e autonomisë, nëpërmjet shërbimeve rezidenciale ndaj shërbimeve të punës dhe llojeve të ndryshme të mbështetjes.



Skema e Nën-Granteve synon të mbështesë zhvillimin e shërbimeve sociale në komunitet dhe iniciativat e biznesit të vogël të menaxhuara nga OSHC-të nga vendet e IPA-s, duke synuar njerëzit me aftësi të kufizuara dhe problemet e shëndetit mendor. Gjatë vitit 2018, Caritas Kosova zhvilloi vizita të rregullta monitoruese në katër OSHC fituese të granteve të dhëna dhe kemi ndjekur nga afër përparimin e tyre në ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara. Të gjitha nën-grantet kanë përfunduar projektet e

tyre në orarin e paraparë nga muaji Shtatorit 2017-Shtator 2018 dhe rezultuan të jenë shumë të suksesshme.

Grupet punuese për përfshirjen sociale/një përbërje e anëtarëve institucional nga niveli qëndror dhe rajonal së bashku me anëtarët e OSHC-ve që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara të cilat janë takuar rregullisht gjatë vitit 2018 dhe kanë përpunuar tema të ndryshme që lidhen me PAK.

Ideja është që në gjysmën e parë të vitit 2019 të prodhohet një material rekomandimi si rezultat i raporteve nga këto grupe punuese dhe t’iu rekomandohet institucioneve relevante që të punojnë në përmirësim duke u bazuar në keto rezultate.

Gjatë këtij viti kemi përdorur një sistem online të fushatës e cila filloi më 1 tetor

2018 paralel me aktet e tjerë të përfshirë. Çdo ditë u promovua një mesazh ndërgjegjësimi rreth çrregullimit të shëndetit mendor në kanalet e komunikimit të Caritas Kosova. Fushata kishte një mesazh të zakonshëm:

#itcanhappentoanyone/ #mundtin-dodhcdokuj

Partnerët: Bashkimi Evropian, Caritas Austria

Përfshirja Sociale e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Caritas Kosova punon intenzivisht në zhvillimin e projekteve për të përkrahur përfshirjen sociale të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shoqërinë kosovare, me theks të veçantë në përmirësimin e mirëqenies sociale dhe ekonomike të këtyre komuniteteve. Duke u bazuar në gjendjen e rëndë socio-ekonomike, arsimore dhe kulturore të këtyre komuniteteve, Caritas Kosova ka fokusuar aktivitetet e saja në katër komponentë kryesorë, në Edukim, Kulturë, Shëndetësi dhe Asistencë Sociale. Përkundër intervenimit në shumë fusha këto komunitete vazhdojnë të përballen me probleme të mëdha, sidomos me papunësinë, mospërfshirjen, segregimin, infrastrukturën e pakët, etj.

Qendra Sociale-Edukative ‘Caritas Kosova’ në Dubravë, Ferizaj - Caritas Kosova edhe gjatë vitit 2018 ka realizuar aktivitete edukative, kulturore dhe sociale duke përfshirë shërbime shëndetsore në Qendrën Sociale Edukative ‘Caritas Kosova’ në Dubravë. Çdo ditë rreth 50 fëmijë të moshës 4 deri 6 vjeç ndjekin klasat parashkollore si përgatitje për fillimin e shkollës. Përtej punës me fëmijët, ne kemi arritur të rrisim ndërgjegjësimin e prindërve që arsimi është shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për të ardhmen e fëmijëve të tyre.

Në këtë kontekst, Caritas Kosova ka organizuar marshin në qendër të qytetit të Ferizajt së bashku me organizatën Terre Des Hommes, Drejtorinë e Arsimit të komunës së Ferizajt, shkollat e mesme të ulta: Tefik Canga, Jeronim De Rada, Gjon Serreçi, Ahmet Hoxha, Vezir

Jashari si dhe shoqatat: Hendifer dhe Fëmijët me Fibrozë Cistike. Në kuadër të Qendrës ekziston Ekipi për parandalimin e braktisjes së shkollës i cili gjatë vitit 2018 ka rikthyer në shkollë 3 nxënës që kishin braktisur procesin mësimor.



Më shumë se 220 nxënës të klasave 1-9, të fshatit Dubravë, të cilët ndjekin mësimin e rregullt në shkollën fillore Naim Frashëri në fshatin Zaskok, marrin pjesë rregullisht në programin e mësimi plotësues të Qendrës. Përveç mbështetjes në detyra të shëpësisë, nxënësit zhvillojnë aktivitete të shumta

psiko-sociale, kulturore, sportive dhe kontibojnë në mënyrë aktive në të gjitha aktivitetet përmes të cilave zgjerojnë njohuritë dhe rrisin nivelin e socializimit dhe përfshirjes. Në bashkëpunim të ngushtë me autoritet e shkollës kemi monitoruar nivelin e zhvillimit të nxënësve, të performancës së tyre,

si dhe sjelljen dhe përparimin e gjithmbarshëm të tyre. Gjithashtu në këtë periudhë kemi zbatuar aktivitetet me prindërit dhe fëmijët e riadhesuar. Me qëllim të ngritjes së nivelit të edukimit të fëmijëve dhe vetëdijesimit në lidhje me migrimin ilegal kemi zhvilluar 8 seanca psiko-sociale me prindër dhe 8 seanca me lojra psiko-sociale me fëmijë. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në këto seanca ka qenë 320. Caritas Kosova në këtë Qendër ofron edhe shërbimet shëndetësore ambulantore dhe stomatologjike, pa pagesë, për banorët e Dubravës. Gjatë vitit 2018 kemi ofruar 2936 shërbime shëndetësore.

Qendra Sociale-Edukative 'Caritas Kosova' në lagjen Ali Ibra, Gjakovë – edhe gjatë vitit 2018 Caritas Kosova ka vazhduar ofrimin e shërbimeve për 180

fëmijëve të lagjes Ali Ibra në Gjakovë. Aktivitetet konsistojnë në shërbime edukative dhe aktivitete psiko-sociale, në baza ditore. 40 fëmijë të moshave 4 deri në 6 vjeç kanë ndjekur edukimin parashkollor. Ndërsa 140 fëmijë të shkollave fillore kanë vijuar programin e mësimi plotësues. Janë zhvilluar në vazhdimësi aktivitete psiko-sociale, kulturore dhe sportive në mënyrë që të ndikohet në një aspekt holistik për të përkrahur përfshirjen sociale të fëmijëve të lagjes në shoqërinë e përgjithshme. Në vitit 2018, Ekipi i Home Care ka vazhduar me ofrimin e shërbimeve sociale dhe shëndetësore për 50 persona të sëmurë të lagjes Ali Ibra. Po ashtu janë organizuar trajnime në lidhje me rëndësinë e përkujdesit dhe ruajtjes së shëndetit.



Mbështetja e përfshirjes sociale të fëmijëve dhe të rinjve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Mahallën e Romëve në Mitrovicë - Caritas Kosova me mbështetjen e UNICEF zbaton këtë projekt i cili kryesisht përqëndrohet në parandalimin e braktisjes së shkollës dhe identifikimin e nevojave për zhvillimin e fëmijëve në përgjithësi dhe të fëmijëve jashtë shkollës në veçanti. Metodologjia Portage është përdorur si pikë fillestare në identifikimin e nevojave zhvillimore të fëmijëve dhe përfshirjen e prindërve në zgjidhjen e këtyre çështjeve. 74 fëmijë janë pëfshirë në projekt dhe janë realizuar 280 vizita në familjet e tyre.

Programi i parandalimit të dhunës kundër fëmijëve - siguria e rrjetit dhe gatishmëria e reagimit – Ky programi ka siguruar dhe forcuar koordinimin dhe bashkëpunimin me të gjithë akterët që merren me çështjet e të drejtave të

fëmijëve në terren me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në mënyrë plotësuese në dobi të interesit të fëmijëve dhe familjeve që banojnë në pjesën veriore të vendit. Në këtë drejtim janë përforcuar mekanizmat për identifikimin, raportimin dhe referimin e rasteve të dhunës kundër fëmijëve, si dhe janë krijuar mundësi për zhvillimin e shërbimeve sociale të inovacionit. Modulet e avancuara të trajnimit kanë përmirësuar kapacitetet e më shumë se 120 zyrtarëve komunal (profesionistë të mbrojtjes së fëmijëve dhe shëndetit, ekipe shkollore, organizata relevante të shoqërisë civile, policë dhe menaxher të rasteve) në 4 komuna. Përfitues direkt të projektit ishin 32 anëtarë të ekipit të parandalimit të dhunës në shkolla, 20 anëtarë të institucioneve të mbrojtjes së fëmijëve dhe OSHC-ve përkatëse, 15 anëtarë të grupit të punës për menaxhimin e rasteve, 160 fëmijë shkollore, 80 prindër dhe 700 fëmijë.

Ushqim për të gjithë

Përkrahja e të varfërve vazhdon të jetë një nga preokupimet kryesore të Caritas Kosova. Me moton e Caritas Internationalis "Ushqim për të gjithë", Caritas Kosova ka përkrahur në vitin 2018 mbi 500 familje, që jetojnë në varfëri ekstreme të cilëve u janë shpërndarë ushqim, veshëmbathje dhe mobile të ndryshme në sasi prej 102 Ton. Shumë persona janë ndihmuar në bash-

këpunim me Kishën Katolike, Institucione shtetërore dhe Organizata që veprojnë në Kosovë. Ky aksion është zhvilluar me: Famullitë, Kuvendet e motrave të nderit, Mensën për të varfër në Prishtinë, Çerdhet e fëmijëve, Drejtoritë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komuna të ndryshme, Shkolat, Strehimore, Shoqatat e pensionistëve, SOS fshati, etj.

Partnerët: Junge Leute Helfen

Përtej Portave të Burgut

Që nga fillimi i vitit 2018, Caritas Kosova, ka vazhduar projektin 'Nga parandalimi, nëpërmjet trajtimit dhe rehabilitimit deri në ri-integrim të suksesshëm' duke realizuar aktivitetet e parapara në: Art Terapi, Teatër Terapi, Sport, Punë praktike në Rrobaqepsi dhe trajnime në Agrokulturë.

Në kuadër të aktivitetit në Art Terapi janë realizuar 10 seanca ku 15 pjesëmarrës nëpërmjet pikturës kanë shprehur ndjenjat momentale dhe vizionet për të ardhmen. "Nëpërmes pikturës Unë kam përmirësuar lidhjet shoqërore dhe familjare" - është shprehur nga një përfituesit. Në fund të vitit është realizuar Ekspozita me punimet e të burgosurve ku morën pjesë të gjithë akterët e përfshirë në këtë projekt.

Përmes Teatër Terapisë rreth 25 përfitues

kanë pasur mundësi për të eksploruar kreativitetin e tyre në Qendrën Korrektuese dhe Qendrën për Fëmijët me Masa Edukuese dhe Korrektuese në Lipjan, për të përmirësuar vetëbesimin dhe për të zhvilluar ndjeshmërinë dhe imagjinatën.

Rreth 20 vullnetarë të Caritas Kosova, bashkëmoshatarë të të dënuarve, vazhdimisht organizojnë aktivitete në diciplinat të ndryshme sportive (futboll, basketboll, volejbol, ping pong) për të ndikuar pozitivisht në socializimin dhe nxitjen e marrëdhënjeve në mes të të dënuarve, stafit të projektit dhe stafit të qendrave korrektuese. Organizimet e tilla ndikojnë drejtpërsëdrejti në uljen e zemërimit, rehabilitim si dhe kanë ndikim shumë pozitiv në shëndetin fizik dhe emocional.



Është organizuar edhe një trajnim teorik dhe praktik në lidhje me agrikulturën dhe qëllimi i këtij trajnimi ka qenë që të miturit të përfitojnë disa nga njohuritë për kultivimin e perimeve në ambiente të mbrojtura (sera) dhe në fushë të hapur. Sipas vlerësimeve, pjesëmarrësit i kanë përceptuar disa njohuri bazë të cilat do

të ju ndihmojnë në aktivitetet e tyre pas përfundimit të burgut, si dhe disa nga njohuritë do të mund t'i përcjellin edhe të familjarët e tyre.

Më 7 Dhjetor 2018 Caritas Kosova ka organizuar tryezën e rrumbullakët me temën: Efikasiteti i programeve të rehabilitimit në Qendrat Korrektuese.



Në këtë tryezë ku morën pjesë të gjitha institucionet relevante korrektuese dhe sprovuese është theksuar rëndësia e organizimit të aktiviteteve të ndryshme për të trajtuar dhe rehabilituar të rinjt dhe gratë e burgosura, që edhe ata të përjetojnë se dikush kujdeset për dinjitetin e tyre, përkundër rethanave dhe të kaluarës. Përveq tjerash u tha që Arti,

Sporti dhe Teatri janë qasje shumë e dobishme dhe kreative në punën me të burgosurit duke siguruar mundësi të vetë-përcaktimit, vetëbesimit, socializimit, dhe të zhvillimit të empatisë. Po ashtu, gjatë kësaj ngjarje u ekspozuan piktura dhe vizatime të bëra nga të rinjtë e burgosur.

Edukimi i Fëmijëve

Kopshti Engjujt - Në kuadër të programeve dhe projekteve të veçanta që zbaton Caritas Kosova, edukimi parafillor dhe menaxhimi i kopshteve për fëmijë përbën një nga objektivat e rëndësishme prandaj edhe gjatë vitit 2018 kemi menaxhuar me sukses kopshtin e fëmijëve "Engjujt" me qëllim të ofrimit të shërbimeve edukuese kualitative të kujdesit ditor për fëmijët. Fëmijët

kanë nevojë për një mirëqenie, edukim dhe socializim të një stadardi të lartë human dhe profesional. Misioni ynë është krijimi i një vendi të sigurt, të përshtatshëm, të ngrohtë dhe të planifikuar mirë për fëmijët e moshës 06 muaj deri në 6 vjet në përputhje me veçoritë individuale të secilit fëmijë. Gjatë vitit 2018 kemi ofruar edukim për 200 fëmijë.



Ekonomia Sociale

Caritas Kosova në vazhdimësi promovon ekonominë social si qasje inovative dhe mekanizëm efikas për zvogëlimin e varfërisë si dhe për të përkrahur përfshirjen sociale dhe punësimin. ELBA (Emergency Labour in Balkans) është një iniciativë e projektuar për t'iu përgjigjur krizës ekonomike në Evropën Juglindore de pjesë të këtij projekti janë: Kosova, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Greqia, Mali i Zi,

Serbia dhe Maqedonia. Ekonomia sociale njihet si një mënyrë për të angazhuar dhe për të fuqizuar të gjithë shoqërinë, sektorin publik si dhe sektorin privat, nga organizata fitimprurëse tek organizatat jo-fitimprurëse, nga territoret tek komunitete, për të zhvilluar një model të ri ekonomik që përfshin njerëzit në nevojë si burim aktiv i shoqërisë.



Gjatë vitit 2018 ka vazhduar promovimi i ekonomisë sociale sidomos përmes ofrimit të granteve për ndërmarrjet sociale. Tri grante janë shpërndarë për tri ndërmarrje sociale (Women Wellness Center-Pejë, Melissa-Istog dhe We do it 4 you-Prishtinë) të cilat kanë vazhduar aktivitetin e tyre në fushat përkatëse. Po ashtu Caritas Kosova ka organizuar pjesëmarrjen e ndërmarrësve social në panairin e ndërmarrjeve sociale në Prishtinë si dhe në Beograd, në mënyrë që të ndërmarrësit social të krijojnë kontakte dhe të përcjellin trendin e zhvillimit të ndërmarrësisë sociale.

Në qershor të vitit 2018 është zhvilluar një punëtori në Beograd ku kanë marrë pjesë përfaqësuesit e projektit nga të gjitha vendet anëtare dhe ku janë përcaktuar modalitetet e monitorimit dhe shoqërimit të ndërmarrjeve sociale. Caritas Kosova gjatë vitit 2018 ka zhvilluar vizitë monitoruese dhe shoqëruese për 4 Ndërmarrje Sociale të cilat janë financuar në kuadër të projektit ELBA, për të kuptuar aktivitetin dhe zhvillimin e tyre, duke tentuar që të evitohen sfidat dhe të trajtohen ide të reja për zhvillim të qëndrueshëm.

Partnerët: Caritas Italiana, Secours Catholique – Caritas France, Catholic Relief Services, Caritas Spain

Your Job

Gjatë vitit 2018 Caritas Kosova ka zhvilluar pilot projektin Your Job i cili është fokusuar në përgatitjen e të rinjve për tregun e punës. Kjo është bërë përmes trajnimit në "orientim në karrierë" dhe trajnimit në "ndërmarrësi" të organizuar në bashkëpunim me Kolegjin Univer-

sum. 15 të rinj janë certifikuar pas trajnimit dhe kanë ngritur aftësitë e tyre për të gjetur punë. Po ashtu 4 të rinjë kanë kryer punën praktike në Caritas Kosova e cila do të ju shërbej si bazë në gjetjen e punës në të ardhmen.



Partnerët: Caritas Austria, Caritas Kärnten

Njohuria kundër dhunës dhe trafikimit

Duke filluar nga qershori 2018, Caritas Kosova - Zyra Rajonale në Leposaviq ka filluar të zbatojë një projekt 15-mujor që ndihmon në përmirësimin e ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut në lidhje me problemet e dhunës në familje dhe trafikimin njerëzor, ngritjen e kapaciteteve të organizatave qytetare dhe

institucionale dhe mbështetjen e luftës ekzistuese kundër një nga fenomenet më të mëdha kriminale në botë. Projekti është duke u zbatuar përmes disa komponentëve në mënyrë që të mbulojë grupin më të gjerë të mundshëm të synuar, duke pasur parasysh dimensionet e problemit:

fushatat publike përmes medias elektronike dhe materialeve të shtypura promovuese, informacione dhe prezantime për fëmijët e shkollave fillore dhe të mesme, prezantime/ligjërata për (mësues, psikologë dhe pedagogë) dhe punëtorë të institucioneve të mirëqenies sociale, renovimin dhe pajisjen e dhomave për punë me viktimat e dhunës në familje dhe trafikimin e qenieve njerëzore në qendrat për mirëqenie sociale.

Zonat e synuara janë komunat veriore të Kosovës: Leposaviq, Zveçan, Mitrovica e Veriut, Mitrovica Jugore dhe Zubin Potok. Deri në dhjetor 2018, më shumë se 2.700 studentë dhe rreth 120 të rritur kanë marrë pjesë në aktivitetet tona të projektit: trajnime teknike, punëtori dhe

tryeza të rrumbullakëta.

Gjatë fushatës së mediave; (Anti Trafikimi dhe Dhuna në Familje), të dizajnuara dhe të transmetuara në stacionin televiziv "MIR" që mbulojnë komunat e Kosovës dhe ato ndërkufitare, materiali ynë promovues u vizitua rreth 14000 herë deri në fund të dhjetorit 2018. Gjithashtu në bashkëpunim me punëtorët e Qendrave Sociale dhe Partnerëve, Ekipi i Projektit ka mbështetur drejtpërdrejt katër viktima të dhunës në familje. Mbështetja ka konsistuar në sigurimin e pagesës për qera të një banese si dhe shpërndarjen e pakove për nevojat themelore (ushqim dhe higjienë).



European Union Kosovo


**NJOHJA KUNDËR
DHUNËS DHE TRAFIKIMIT**

human trafficking crime

STOP
DHUNËS & TRAFIKIMIT

LINJA NDËHMËSE 0800 11 112 or 192
antitrafikimi@kosovopolic.com

Save the Children



European Union Kosovo

**KNOWLEDGE AGAINST
VIOLENCE AND TRAFFICKING**

human trafficking crime

STOP
VIOLENCE & TRAFFICKING

HELP LINE 0800 11 112 or 192
antitrafikimi@kosovopolic.com

Save the Children



European Union Kosovo

**ZNANJEM PROTIV
NASILJA I TRGOVINE LJUDIMA**

human trafficking crime

STOP
NASILJU I TRGOVINI LJUDIMA

SOS LINIJA 0800 11 112 or 192
antitrafikimi@kosovopolic.com

Save the Children

Partnerët: Bashkimi Evropian, Save the Children

Emergjencat

SEECEG – Grupi i Emergjencave të Cartas-eve në Evropën Juglindore

Qëllimi i përgjithshëm i këtij grupi është koordinimi dhe Bashkëpunimi i përbashkët në menagjimin e fatkeqsive. Gjatë vitit 2018 anëtarët e Grupit Caritas u takuan në takimin e rregullt vjetor në Bar të Malit të Zi, takim ky i organizuar nga Caritas Mali i Zi dhe i kryesuar nga Caritas Kosova. Ky takim mbledhi anëtarët nga Caritas-et e Shqipërisë, Serbisë, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë, Bosnjes dhe Herzegovinës, Rumanisë, si dhe anëtarë nga Caritas

Europa. Të gjithë anëtarët patën mundësi të ndajnë veprimet e tyre gjatë vitit 2018 nga vendet e tyre në lidhje me fatkeqësitë natyrore dhe gjithashtu diskutuan çështjen e migracionit. SEECEG u kryesua nga Caritas Kosova në 3 vitet e fundit dhe iu dorëzua Caritas Rumanisë, e cila do ta udhëheqë më tej grupin. Veprimi kryesor që u ideua në takim ishte zhvillimi i një projekti të përbashkët rajonal në zvoglimin e rreziqeve ndaj fatkeqësive si dhe në ngritjen e kapaciteve për të menaxhuar krizat.




Partnerët: Caritas Internationalis, Caritas Europa

Buxheti Vjetor


2,657,845.38

Përkujdesi Shtëpiak dhe Ambulantor	1,512,282.01 €
Lufta Kundër Trafikimit me Njerëz	43,738.90 €
Paqa dhe Diversiteti	83,696.00 €
Mbështetja e Personave me Aftësi të Kufizuara	75,704.81 €
Përfshirja Sociale e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian	148,512.61 €
Ushqim për të gjithë	43,715.00 €
Përtej Portave të Burgut	35,488.00 €
Edukimi i Fëmijëve	351,974.90 €
Ekonomia Sociale	16,451.55 €
Your Job	14,969.00 €
Tjera	331,312.60 €

Përqindja sipas Projekteve



Përqindja sipas Donatorëve



Zyra Qendrore - Ferizaj
Rr. Shën Nënë Tereza nr.3,
70000, Ferizaj, Kosovë
tel. +381 (0)290 328 110
e-mail: info@caritaskosova.org

Zyra Regjionale - Prishtinë
Rr. Karposh nr. 41, Kisha Katolike,
Ulpianë
10000 Prishtinë, Kosovë

Zyra Regjionale - Mitrovicë
Rr. Tirana nr. 101
40000 Mitrovicë, Kosovë

Zyra Regjionale - Prizren
Rr. Papa Gjon Pali II nr. 1
20000 Prizren, Kosovë

Zyra Regjionale - Gjakovë
Qendra e Komuniteteve Ali Ibra,
50000 Mitrovicë, Kosovë

Zyra Regjionale - Leposaviq
Rr. Vojske Jugosllavije 16,
43500 Leposaviq, Kosovë